



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/107

Datë: 31.08.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 31 gusht 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohen ekstraktet e procesverbaleve dhe transkripteve nga mbledhjet; 101, 102 dhe 103 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/107

Datë: 31.08.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 31 gusht 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Akreditim.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/107

Datë: 31.08.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 31 gusht 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Ndahen mjete financiare në vlerë prej 80,000,00 (tetëdhjetë mijë) euro, për përmbushjen e kontributit vjetor të Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2015 dhe 2016 në Këshillin për Bashkëpunim Rajonal, me seli në Sarajevë, respektivisht në buxhetin e Sekretariatit të Këshillit për Bashkëpunim Rajonal. Republika e Kosovës bën pjesë në grupin prej 4 % të shumës totale të vendeve të Evropës Juglindore (përcaktuar formalisht në Takimin e Tryezës Rajonale të Paktit të Stabilitetit për EJT në Bukuresht, Nëntor 2006)
2. Mjetet financiare nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga Shpenzimet e Paparashikuara, nën-programi Shpenzimet e Paparashikuara me kod 13100, kategoria ekonomike e rezervës, dhe transferohen në Ministrinë Financave, nën-programi Thesari me kod 11200, në kategorinë ekonomike Subvencione dhe Transfere.
3. Mjetet financiare sipas këtij vendimi barten në xhirollogarinë e Sekretariatit të Këshillit për Bashkëpunim Rajonal (RCC).
4. Obligohet Ministria e Financave, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Zyra e Kryeministrit për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/107

Datë: 31.08.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 31 gusht 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Ndahen mjete financiare në vlerë prej 50,000.00 (pesëdhjetëmijë) euro, për qytetarët e Republikës së Maqedonisë, të cilët janë prekur nga vërshimet me datë 6 dhe 7 gusht 2016.
2. Mjetet financiare nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga Shpenzimet e Paparashikuara, nën-programi Shpenzimet e Paparashikuara me kod 13100, kategoria ekonomike e rezervës, dhe transferohen në Ministrinë Financave, nën-programi Thesari me kod 11200, në kategorinë ekonomike Subvencione dhe Transfere.
3. Obligohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/107


Datë: 31.08.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 31 gusht 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Z. Valon Murtezaj, Zëvendësministër i Punëve të Jashtme i Republikës së Kosovës, emërohet bashkëkryesues në Komisionin për "Bashkëpunim Ekonomik" ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Hungarisë.
2. Obligohet Ministria e Punëve të Jashtme, dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/107

Datë: 31.08.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 31 gusht 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Ndryshohet dhe plotësohet pika 1. e Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/47 i datës 2 shtator 2015, si në vijim:
 - 1.1. Autorizohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave, Ministria e Punëve të Jashtme, Zyra e Kryeministrit dhe Agjencioni Qendror i Prokurimit, për inicimin e procedurave ligjore për përzgjedhjen e përfaqësuesit të autorizuar për mbrojtjen e interesave të Republikës së Kosovës pranë Arbitrazhit, në çështjen e inicuar nga kompania "ACP Axos Capital" GMBH, lidhur me çështjen e privatizimit të Postës dhe Telekomunikacionit Sh.A.
 - 1.2. Obligohen Institucionet nga pika 1.1. e këtij Vendimi që, në bashkërendim me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, të kryejnë veprime nga përgjegjësia e tyre për zbatimin e këtij Vendimi, dhe Vendimit Nr. 10/47 të datës 2 shtator 2015.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë